



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura III  
Komisioni për Integritet Evropian  
Mbledhja nr. 37  
Prishtinë, më 08. 06. 2009, ora 11:15  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL  
I mbledhjes së Komisionit për Integritet Evropian**

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani dhe Naser Rugova.

Mungoi: Branislav Grbić.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës**

- 1. Takim me delegacionin nga Parlamenti i Kroacisë;**
- 2. Shqyrtimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010 - 2012.**

**1. Takim me delegacionin nga Parlamenti i Kroacisë**

**Kryesuesja** – Tha se e kishin ende të freskët mikpritjen që ua kishte bërë vitin e kaluar Kroacia. I përgëzoi për anëtarësimin e Kroacisë në NATO, sepse shërben për stabilizimin e rajonit. Bashkëpunimi ndërparlamentar paraqet një hallkë shumë të rëndësishme dhe është shumë me rëndësi që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen. Shtoi se bashkëpunimi rajonal është njëri ndër kushtet për anëtarësim.

**Nevenka Marinović** - Falënderoi për urimin që i bënë. Paraqiti përbërjen e delegacionit. Shtoi se ishte anëtare e Komisionit të Legjislacionit. Njoftoi për procedurën e miratimit të ligjeve dhe të harmonizimit të tyre me *acquis communautaire*. Tha se nga viti 2003 deri me tani i kishin harmonizuar 396 ligje. Nuk kemi paraparë se do të kemi bllokim nga shteti fqinjë. Njoftoi se negociatat nuk janë hapur në 15 kapituj. Sa i përket miratimit të ligjeve tha se i kishin miratuar shumë shpejt dhe kishin frikë se do të paraqiste problem në të ardhmen, mirëpo një gjë e tillë ishte kërkuar nga ta.

**Tomislav Iliq** - anëtar i Komisionit për Media - Tha se ishin shumë të kënaqur me raportet e vendosura ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe të Kroacisë. Kërkoj që bashkëpunimi ndërmjet dy shteteve të konkretizohet.

**Dzezair Murati** - Tha se vitin e kaluar kishte pasur rastin ta vizitonte Kroacinë. Bashkëpunimi me institucionet kroate është shumë i gjerë dhe duhet të vazhdojë. E përcjellim çdo gjë që ndodh te ju, sepse dikur kemi jetuar në një shtet. I falënderoi për atë që kanë bërë për ne.

**Hydajet Hyseni** - Njoftoi për angazhimet në komisione. Shtoi se është nga Gjilani, në të cilin rajon nevoja e padiskutueshme e decentralizimit është kthyer në një model shumë të diskutueshëm dhe kundërproduktiv, andaj përvoja juaj do të na ndihmonte shumë në këtë drejtim. Tha se e drejton Shoqatën e të Burgosurve Politikë dhe se nuk kishin arritur të bënin asgjë në këtë drejtim, sepse ishin ballafaquar me pengesa serioze. E di se ju e keni një komisionin për veteranë, andaj na duhet përvoja juaj.

**Fatmir Rexhepi** – Dua të di lidhur me rolin e Parlamentit të Kroacisë në procesin e privatizimit, sepse jam edhe anëtar i Komisionit për Ekonomi, Energji e Tregti, Transport e Telekomunikacion, që ka një gamë të madhe.

**Nait Hasani** - Deshi të dinte për eksperiencën e kroatëve lidhur me veteranët e luftës dhe për trajtimin që ua bëjnë atyre.

**Bujar Bukoshi** - I uroi për anëtarësimin në NATO dhe tha: Jua kemi zili për progresin që keni arritur.

**Edita Tahiri** - Tha se kishte qenë një prej lidereve të lëvizjes paqësore për pavarësi. Shtoi se kontaktet me Kroacinë janë vënë shumë më herët. I falënderoi për njohjen e shpejtë të shtetit të Kosovës. Tha se pasi krijimit të Lobit Rajonal të Grave kishte bashkëpunim të ngushtë me disa gra të Parlamentit të Kroacisë.

**Zylfije Hundozi** – Tha se jemi në fillim të procesit të integriteteve, sepse tani jemi bërë shtet. Njoftoi se të gjitha forcat janë orientuar që studimi i vizibilitetit të dalë pozitiv. Sa u përket vërejtjeve të Raportit të Progresit tha se Komisioni për Integritete Evropiane ka hartuar Planin e Veprimit për sfidat që dalin nga Raporti i Progresit. Po ashtu Qeveria e ka hartuar Planin e Veprimit, andaj shpresojmë se së shpejti do ta nënshkruajmë Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

**Tomislav Iliq** – Tha se sa i përket çështjes së veteranëve të luftës, Kroacia ka ministri të veçantë që merret me këto probleme dhe i kushton kujdes shumë të madh veteranëve të luftës. Kemi hartuar rregullat për mbrojtjen e veteranëve të luftës. Kujdes më të madh i kemi kushtuar punësimit dhe risocializimit të luftëtarëve në shoqëri.

**Sabri Hamiti** - Njoftoi se kryetari i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë para një muaji kishin krijuar grupet e miqësisë me shumë vende, andaj një gjë të tillë do të duhej ta bënin shumë shpejt edhe me Kroacinë. U tha se keni një ambasador të shkëlqyer dhe dinamik në Kosovë. Shpresojmë se edhe ne shumë shpejt do ta kemi një ambasador në Zagreb.

**Zylfije Hundozi** - Falënderoi për vizitën që i bënë Kosovës dhe tha shpresojmë se bashkëpunimi të jetë më i dendur dhe më i frytshëm.

## **2. Shqyrtimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010 - 2012**

**Kryesuesja** - Kërkoj nga anëtarët e Komisionit t'i paraqesin propozimet dhe vërejtjet e tyre lidhur me Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010 - 2012.

**Nait Hasani** - Tha se të gjitha dokumentet të cilat nuk i përkasin kompetencave tona mund të procedohen. Duhet t'i shqyrtojmë vetëm ato materiale të cilat janë kompetencë e Komisionit për Integritet.

**Fatmir Rexhepi** - Tha se ky dokument i mbledhjes së kaluar mund të procedohet me propozimet dhe me sugjerimet që janë dhënë.

**Hydajet Hyseni** - Propozoi që ky dokument të harmonizohet me PVPE-në.

*Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë*

### ***Përfundim***

***Korniza është në përputhje me PVPE-në dhe ia rekomandon Kuvendit për procedim të mëtejshëm.***

Mbledhja përfundoi në ora 12:20 min.

E hartoi:  
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

\_\_\_\_\_  
Zylfije Hundozi